

AKT THEMELIMI

DHE

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

N&H KATESHI SHPK

Sot me date 27/.../...10.2025 (dy mije e njezete e pese) ortaku themelues

Z.Rogert Kateshi, shtetase shqiptare lindur dhe banuese ne Tirane, me 25.04.1983, mbajtes i leternjoftimit nr id 039780049 dhe (nr personal I30425068B), madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar,

Ka vendosur te formoje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar konform ligjeve te Republikes se Shqiperise dhe dispozitave te meposhteme:

KAPITULLI 1

EMRI, FORMA LIGJOTE E SHOQERISE, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA

Neni 1

THEMELIMI DHE FORMA LIGJORE

1.1 Emri I Shoqerise **N&H Kateshi shpk** ne vijim referuar si Shoqeria.

1.2 Shoqeria eshte themeluar ne formen e nje Shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ligji nr 9901,date 14.04.2008 "*Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare*", i ndryshuar (*Ligji I Shoqerive Tregtare*)

1.3 Shoqeria fiton personalitet Juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Regjistrimit

1.4 Aktiviteti I Shoqerise do te ushtrohet ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise dhe dispozitave te ketij Akt Themelimi dhe Statuti.

Neni 2

SELIA

2.1 Selia e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise eshte ne adresen "**SAUK' Ndertese, Siperfaqe 134.80, Nr pasurie 147/4-ND, ZK 3266, VOL.31, FAQE 3' Tirane.**" Shoqeria ka te drejte te ndryshoj seline e saj ne nje adrese dhe /ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise.

2.2 Shoqeria, me miratimi te Asamblese se Pergjitheshme mund te hap dege te saj ose zyra kudo Brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Ndersa, Administratori i Shoqerise mund te cele, transferoj dhe/ose mbyll, si ne Shqiperi ashtu dhe jashte saj, Seli sekondare te Shoqerise.



OBJEKTI I SHOQERISE

3.1 Objekti paresor i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

- a) Agjensi komisioneresh per transferta parash. Agjent per veprimtari financiare te transferimit te parave ne emer dhe per llogari te nje subjekti jo banke.
- b) Kembim Valutor
- c) Import-Eksport, tregetimin e te gjitha llojeve te artikujve ushqimore dhe pije alkolike pa kufizim, me shumice dhe pakice si dhe tregetimin e artikujve te ndryshem industrial dhe cdo lloj artikull/produkt tjeter qe nuk ndalohe nga legjislacioni shqiptar.
- d) Botime dhe katalogje promocionale per marketing.
- e) Bar Kafe-Wine Bar. Botim, etiketim dhe vjeterim vere. Kantine vere, vjeterim, ambalazhim, perpunim produktesh bujqesore.
- f) Agroturizem dhe turizem, ne fushen e hoteleri, bujtine, turizem, kafe, bar-kafe.
- g) Shitje-blerje, dhenie me qera magazinim dhe tregetim me shumice dhe pakice te produkteve te ndryshme ushqimore, alkolike dhe pijeve freskuese te bar- resorant, produkteve bujqesore dhe blektorale, produkteve te ndryshme industriale dhe cfardo lloj artikulli/produkti tjeter pa kufizim tipi, lloj, kategori qe nuk ndalohe nga legjislacion shqiptar.
- h) Cdo lloj aktiviteti qe lidhet me lidhet me pasurite e luajteshme dhe te pauajteshme, veprime bankare, financiare te cfardo lloj natyre, si dhe konsulenca dhe asistence teknike te dobishme per arritjen e Objektivit te Shoqerise permendur me siper si dhe,
- i) Cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te Shoqerise e qe nuk bie ndesh me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

3.2 Shoqeria mund te bashkepunoj dhe/ose zoteroj pjesmarje direkte ose indirekte ne shoqeri te tjera, firma agjenci dhe sipermarje te cilat kane objekt veprimtari te ngjashme me te.



Neni 4

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

4.1 Shoqeria do te themelohet per nje kohezgjatje (afat) te pa caktuar, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KAPITULLI II

KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT/PJESE TE KAPITALIT

Neni 5

KAPITALI THEMELTAR DHE ORTAKET

5.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 1.000 (nje mije) leke me 1 (nje) kuote me vlere nominale 1.000 (nje mije) leke e zoteruar nga Ortaku themelues si me poshte vijon:

Z. Rogert Kateshi, ne cilesine e ortakut Themelues, zoteron 100 % te vleres se kuotave te kapitalit fillestar te Shoqerise, te barabarte me nje kuote ne vlere nominale 1.000 (nje mije) leke.

5.2 Kapitali themeltar eshte derdhur teresisht nga ortakut themelues.

5.3 Kuotat e Ortakeve te Shoqerise jane lirisht te transferueshme sipas legjislacionit Tregetar ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

5.4 Ortaket e Shoqerise pergjigjen per detyrimet kundrejt te treteve deri ne vleren e koontributit te tyre ne kapitalin themeltar te saj.

5.5 Cdo kuote i jep te drejten e nje vote cdo Ortaku, ne Asamblene e Pergjitheshme te Ortakeve (Asambleja e Pergjitheshme), te drejten per te zgjedhur dhe per tu zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te mare pjese ne shperndarjen e fitimit te Shoqerise, si kunder te drejta te parashikuara nga ky Status, dhe dispozitave ligjore te Ligjit te Shoqerive Tregetare.

KAPITULLI III

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 6

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

6.1 Asambleja e Pergjithshme, ligjerisht e thirrur dhe rregullisht e mbledhur eshte organi me I larta vendimares I Shoqerise. Vendimet e saj te mara ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dispozitave te ketij Akt Themelimi dhe Statusi, jane te detyrueshme per tu ndjekur dhe zbatuar,

6.2 Asambleja e Pergjithshme ka keto funksione:



- a) Percakton politikat tregetare dhe ekonomike te Shoqerise dhe mbikqyr zbatimin e tyre nga Administratori duke perfshire raportimin financiar.
- b) Emerton dhe shkarkon Administratorin (et) dhe zevedesve te tij, Drejtorin (et) e Finances, ekspertin (et) kontabel dhe ose likujduesin (et) e Shoqeries.
- c) Percakton paga dhe shperblimet per Administatorin (et) ekspertin (et) kontabel dhe likuiduesit (et) e Shoqerise.
- d) Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise te pergatitura nga Administratori.
- e) Merr vendime me ndryshime te ketij Akt Themelimi dhe Statusi te Shoqerise
- f) Merr vendime per zmadhimin ose zvogelimin e Kapitalit te Shoqerise, pjestimn e kuotave, shperdarjen e fitimeve dividenteve.
- g) Merr vendim per ristrukturimin ose prishjen/ likujdimin e Shoqerise
- h) Merr vendime per hapjen e degeve dhe/ose zyrove te perfaqesimit te Shoqerise brenda dhe jashte Republikes se Shqiperise.
- i) Merr vendimin per themelin e Shoqerive te reja Joinit Venture ose aleanca qe lidhen me shitjen blerjen, pjesmarjen dhe investimin ne projekte ekzistuese dhe te reja.
- j) Vendos per dhenien dhe marjne e fondeve huave ose paradhanien nga Ortaket dhe Administratoret per nevoja personale dhe per financim biznesi.
- k) Miraton kerkesa te reja dhe vendos per rinovimin e kerkeseve ekzistuese per financim.
- l) Vendos per bllokimin dhe lenine peng te pasurive te paluajteshme prane Zyres se Pasurive te Paluajteshme.
- m) Miraton buxhetin vjetor te Shoqerise si dhe investimet dhe shpenzimet te cilat nuk jane parashikuar ne buxhetin vjetor.
- n) Vendos per blerjen e pasurive te paluajteshme
- o) Miraton planin e kontrollit te brendeshem dhe rregulloreve te Shoqerise: si dhe
- p) Merr vendime per cdo ceshtje tjeter te rendesishme te parashikuar nga ligji apo Statusi.

Neni 7

MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

7.1 Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese, ose nese parashikohet nga Statusi, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik do te permbaj vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithë Ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjet e asamblese.

7.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori ose nga nje a me shume ortake qe perfaqesojne te pakten 5 % te kapitalit te Shoqerise.

7.3 Me rastin e marjes se vendimeve qe kerkojne shumice te zakonshme, asambleja e pergjitheshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote te cilet zoterojne me shume se 30 perqind te kuotave. Asambleja e Pergjithshme vendos me tre te katerat e kuotave te ortakeve pjesmarres per ndryshimin e statusit, zmadhimin ose



zvogelimin e kapitalite te regjistuar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe Prishjne e Shoqerise. Per ceshtje te tjera Asambleja e Pergjitheshme vendos me shumice te kuotave te ortakeve pjesmares. Cdo kuot jep te drejten e nje vote.

7.4 Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendos per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishme personalisht , vootjne me shkrese apo mjete elektronike.

7.5 Nese Asambleja e Pergjitheshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se korumit te perdorur ne piken 3 dhe 4 te ketij neni Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, ne te njejten dite.

Neni 8

REGJITSRI I VENDIMEVE

8.1 Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme duhet te regjistrohen ne Regjistrin e Vendimeve, te dhena te cilat nuk mund te ndryshohen. Regjistir I vendimeve duhet te mbahen nga Administratori dhe cdo regjistrim duhet nenshkrar nga Administratori.

Neni 9

ADMINISTRATORI

9.1 Administratori dhe mandati perkates.

9.1.1 Shoqeria administrohet nga 1 (nje) Administrator I emeruar nga Asambleja e Pergjitheshme.

9.1.2 Administratori i Shoqerise eshte **znj. Rogert Kateshi**, shtetase shqiptare, lindur dhe banuese ne Tirane me 25.04.1983, mbajtese e leternjofimit nr id **039780049** dhe (nr personal **I30425068B**).

9.1.3 Mandati I Ambasadorit eshte 5 (pese) vjet, i rinovueshme dhe zgjat deri ne vendimin pasardhes te Asambelse se Pergjithshme, qe vendos per revokimin, e mandatit te tij apo emertimin e administratorit (eve) te ri.

9.2 Te drejta e Administratorit

9.2.1 Shoqeria perfaqesohet ndaj te treteve nga Administratori.

9.2.2 Administratori, pervec kompetencave te parashikuara ne Ligj per Shoqerite Tregtare, permes ketij statusi ka te drejtat dhe detyrimet e meposhteme.

- a) Administron veprimtarine e Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike te percaktuar nga Asambleja e Pergjitheshme.
- b) Perfaqeson Shoqerine ne mardhenie me cdo pale te trete.



- c) Merr masa per hartimin dhe mbajtjen ne menyre te duhur te pasqyrave financiare dhe dokumentave.
- d) Pergatit dhe nenshkuan pasqyrat financiare vjetore dhe bilancet e konsoliduara, pergatit raportin e ecurise dhe ia dorezon keto te fundit bashke me propozimin perkates per shperndarjen e fitimeve Asamblese se Pergjithshme per miratim.
- e) Krijon systemin e paralajmerimit ne lidhje me rrethanat, qe kercenojne veprimtarine e Shoqerise.
- f) Dorezon ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dokumentat me te dhenat e Shoqerise , pervec rasteve kur ligji parashikon te kunderten.
- g) I raporton Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare te Shoqerise dhe ne lidhje me permbushjen e transaksioneve te nje rendesie te vecante per ecurine e Shoqerise.
- h) Kryen blerjet shitje nenshkrimet e kontratave me pale te treta per mallra, pune sherbim apo cdo lloj mardheni tjeter e cilat nuk eshte nen pergjegjesine direkte te Asamblese se Pergjitheshme.
- i) Kyren cdo detyre tjeter te parashikuar nga ligji ose nga ky Status.
- j) Administratori mund te autrizoj nepermjet nje prokure nje person te trete per te perfaqesuar Shoqerine dhe per te nenshkruar cdo document, kerkese ose aplikim ne emer dhe per llogari te Shoqerise
- k) Administratori eshte pergjegjes ndaj Shoqerise per c,do dem te shkaktuar si pasoj e mospermbushjes se detyrimeve te parashikuara nga dispozitat e ketij Statusi dhe legjislacionit ne fuqi.

Neni 10

EKSPERTI (ET) KONTABEL TE JASHEM

10.1 Pasqyrat financiare te Shoqerise do te auditohen te pakten nje here ne vite nga nje, apo me shume, ekspert kontabel te jashtem. Me marjen ne dorezim te raportit perkates te auditimit Administratori i Shoqerise do te marre te gjitha masat perkatese per ndreqjne e parregullsive te konstatuara nga raporti.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR DHE SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 11

VITI FINANCIAR

11.1 Viti financiar fillon nga data 1 janar dhe perfundon me date 31 dhjetor te cdo viti kalendarik. Viti paren financiar nis ne daten e themelimit te Shoqerise.

11.2 Ne perfundim te vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare te Shoqerise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.



11.3 Bilanci dhe raporti I ecurise I hartuar prej Administratorit dhe raporti qe, eventualisht, hartohet prej ekspertit kontabel te emeruar, miratohet prej Asamblese se zakonshme me shumicen e votave.

Neni 12

SHPERNDARJA E FITIMEVE

12.1 Pas miratimit te pasqyrave financiare vjetore , Asambleja e Pergjitheshme vendos ne lidhje me Shperndarjen ose jo te fitimit, nese ka. Fitimi u shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara.

KAPITULLI V

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 13

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

13.1 Ne raste se Asambleja e Pergjithshme vendos prishjen e Shoqerise do te emerohet nje ose me shume likuidues.

13.2 Eksperti kontabel i Shoqerise do te emerohet nga Asambleja e Pergjitheshme nese emerimi i tij eshte i detyrueshem ne baze te legjislacionit ne fuqi. Mandati i Ekspertit kontabel eshte i rinovueshem ne vendim te Asamblese se Pergjitheshme.

KAPITULLI V

DISPOZITA PER FUNDIMTARE

Neni 14

LIGJI I ZBATUESHEM

14.1 Per te gjithë ceshtjet nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi dhe Statut i Shoqerise do te zbatohen dispozitat perkatese te Legjislacionit Shqiptar ne lidhje me Shoqerite Tregtare.

Neni 15

TE NDRYSHME

15.1 Ky Statut mund te ndryshohet apo shfuqizohet, ose nje Statut i ri mund te miratohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

15.2 Largim dhe perjashtim i nje Orataku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit te Shoqerive Tregtare.



15.3 Vula e Shoqerise do te kete shkruar emrin e Shoqerise dhe NIPTIN e Shoqerise

15.4 Te gjitha mosmarveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e ketij Akt Themelimi dhe Statuti me mes Shoqerise, Administratorit dhe Asamblese se Pergjithsme , do te lihen nen kompetencen eskluzive te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

15.5 Ky Akt Themelim dhe Status I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “**N&H KATESHI shpk**” perpilohet ne 3 (tre) kopje ne gjuhe shqipe dhe nenshkruhet rregullisht nga Ortaku themelues, sot me date *27.10/*....2025, ne Tirane.

ORTAKU THEMELUES

ROGERT KATESHI

Rogert. Kateshi
[Signature]